



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA
DIREKTORIA E ADMINISTRATIVË - UDRAVA ADMINISTRACIJE

Dokument më Dostavljeno 16.01.2024

Nr. org. / Org. jed.	Nr. / Br.	Shtojcë - Prilog
02-016/01-00045	22/24	



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE I N.P.L "EKO LLAPI" SH. A PODUJEVË

Në mbështetje të nenit 5.2, nenit 7, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 164, dhe nenit 182 nën par. 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 24.05.2018, bazuar në Konkursin Publik të shpallur nga Komuna e Podujevës me datë 01.12.2023 me nr. të protokollit 0085163 lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komisioni Komunal i Aksionarëve të N.P.L "Eko Llapi" Sh. A në përbërje prej 1. Burim Hasani — Kryesues i Komisionit, 2. Bahri Blakçori — Anëtar i Komisionit dhe 3. Avni Fetahu— Anëtar Komisionit në mbledhjen e mbajtur me datë 16.01.2024, nxjerrin këtë:

VENDIM

(Për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të N.P.L "Eko Llapi" Sh. A)

1. Pas zhvillimit të të gjitha fazave të procedurave të rekrutimit, dhe rezultateve të arritura nga intervista me gojë, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka përzgjedhur anëtarët e Bordit të Drejtorëve të N.P.L "Eko Llapi" Sh. A si në vijim:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pikët
1	Besart Nishefci	97
2	Besnik Mehmeti	96
3	Ganimete Dragusha Ganiu	94
4	Luljeta Bryma latifi	93

2. Ky vendim është marr nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve të cilët kanë arritur në këtë përfundim pas vlerësimit të intervistës me gojë.
3. Detyrat dhe Përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-11 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
4. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes do të jetë në periudhë tre (3) vjeçare.
5. Kompensimi i Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes, do të bëhet në pajtim me nenin 20 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
6. Për kryerjen e detyrave të cekura në par. 3 të këtij vendimi, Bordi i Drejtorëve i raporton dhe i përgjigjet Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Arsyetim

7. Me datë 01.12.2023 është shpallur konkursi publik për përzgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, ku periudha e aplikimit ka qenë i hapur nga data 01.12.2023 deri me datë 26.12.2023 në ora 16:00.

8. Për t'u përzgjedhur për Anëtarë të bordit të Drejtorëve kanë aplikuar 24 kandidatë ku 5 prej tyre kanë munguar në intervistë. Kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet e konkursit publik janë njoftuar në lidhje me datën dhe orën se kur do të mbahet intervistimi me gojë, dhe atë janë njoftuar në faqën zyrtare të Komunës dhe me anë të telefonit (mesazh).

9. Pas përfundimit të intervistimit me gojë, kandidatët e suksesshëm në bazë të pikëve të fituara janë si në vijim:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pikët
1	Besart Nishefci	97
2	Besnik Mehmeti	96
3	Ganimete Dragusha Ganiu	94
4	Luljeta Bryma latifi	93

Pas zhvillimit të të gjitha fazave të procedurave të rekrutimit, kandidatët në bazë të pikëve të fituara nga intervista me gojë dhe të cilët nuk kanë arritur pikët e mjaftueshme për t'u përzgjedhur për anëtarë të Bordit të Drejtorëve janë si në vijim:

5	Herolind Lahu	92
6	Mahir Blaku	92
7	Arsim Rashiti	91
8	Adhurim Uka	90
9	Rexhep Zebica	90
10	Fadil Luta	90
11	Faton Jashari	89
12	Labinot Elezi	89
13	Behram Duriqi	88
14	Bujar Blaku	87
15	Labinot Breznica	86
16	Visar Hoxha	85
17	Vlora Fazliu	83
18	Hatixhe Krasniqi	81
19	Mehmet Rexhepi	80
20	Valona Hasani	Mungoi
21	Ejup Begu	Mungoi
22	Pajtim Hodolli	Mungoi
23	Faton Bajgora	Mungoi
24	Mustafë Avdiu	Mungoi

Detyrat dhe Përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-11 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes do të jetë në periudhë tre (3) vjeçare. Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes, do të bëhet në pajtim me nenin 20 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Komisioni Komunal i Aksionarëve në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë e parapara ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kandidatët të cilët kanë aplikuar për këto pozita dhe nuk janë përfshirë në këtë listë, kanë të drejtën të parashtrojnë ankesë brenda Gjykatës kompetente brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit të njoftimit. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij vendimi (nuk ka efekt suspensiv).

Vendimi publikohet në webfaqen zyrtare të Komunës së Podujevës dhe në këndin e njoftimeve si kopje fizike dhe të njejtin vendim kandidatet mundë ta marrin në kopje fizike tek Zyra e Arkivës së Komunës së Podujevës.

Komisioni:

Burim Hasani Kryetar:

Bahri Blakçori Anëtar:

Avni Fetahu Anëtar:



16.01.2024